



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 24 prot.

Kamëz, më 21.3.2025

V E N D I M
Nr. 22.Datë 21/3 2025

MBI

NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.113, DATË 20.11.2024

“MIRATIMIN E LISTËS SHITESË SË SUBJEKTEVE, POSEDUES TË NDËRTIMEVE PA LEJE QË PREKEN NGA “NDËRTIMI I AMFITEATRIT DHE FUSHAVE SPORTIVE, KËNDIT TË LOJËRAVE DHE SHKALLËVE PANORAMIKE NË LIQENIN E PASKUQANIT”, TË CILËT PËRFITOJNË SUBVENCIONIM TË QIRASË SIPAS PARASHIKIMEVE TË VKM NR. 409, DATË 15.06.2022 “PËR RREGULLAT, MËNYRAT DHE AFATET E TRAJTIMIT TË POSEDUESVE TË NDËRTIMEVE PA LEJE QË NUK LEGALIZOHEN”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 21.03.2025, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.21 Datë 19.03.2025, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative së Republikës së Shqipërisë”; Ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social” i ndryshuar; Ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”; VKM nr. 409, datë 15.06.2022 “Për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesve pa leje që nuk legalizohen”; Urdhër i Kryetarit të Bashkisë Kamëz me nr. 1048, prot, datë 08.11.2024 “Për një ndryshim në urdhrin nr. 919, datë 04.10.2024 “Për mbledhjen e dokumentacionit dhe përgatitjen e dosjeve të subjekteve që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i amfiteatrit dhe fushave sportive, këndit të lojërave dhe shkallëve panoramike në liqenin e Paskuqanit dhe zgjerimi i rrugës “Hajri Skeja” Njësia Administrative Paskuqan; VKB nr. 106, datë 24.10.2024 “Mbi miratimin e manualit të procedurave për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen dhe që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i amfiteatrit dhe fushave sportive, këndit të lojërave dhe shkallëve panoramike në liqenin e Paskuqanit” Njësia Administrative Paskuqan; **Këshilli Bashkiak Kamëz”;**

V E N D O S I:

1. Miratimin e një shtese në vendimin nr. 113, datë 20.11.2024, në listën e subjekteve përfituese shtohet subjekti Znj., me ID
2. Znj. do të trajtohet si subjekt përfitues që do të trajtohet në formën e bonusit të qirasë për një afat 3-vjeçar nga momenti i firmosjes së marrëveshjes dhe lëshimit të godinës së banimit duke zbatuar nivelin e qirasë për frymë sipas vendimit të **Këshillit Bashkiak nr. 106, datë 24.10.2024 “Mbi miratimin e manualit të procedurave për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen dhe që preken nga realizimi i**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

projektit “Ndërtimi i amfiteatrit dhe fushave sportive, këndit të lojërave dhe shkallëve panoramike në liqenin e Paskuqanit” Njësia Administrative Paskuqan, sipas përcaktimeve ligjore që bën VKM nr. 409 datë 15.06.2022.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet grupi i punës i ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë me nr. 1048, prot, datë 08.11.2024 “Për një ndryshim në urdhrin nr. 919 datë 04.10.2024, “Për mbledhjen e dokumentacionit dhe përgatitjen e dosjeve të subjekteve që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i amfiteatrit dhe fushave sportive, këndit të lojërave dhe shkallëve panoramike në liqenin e Paskuqanit” Njësia Administrative Paskuqan si dhe Drejtoria e Strehimit dhe Emergjencave Civile pranë Bashkisë Kamëz.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimit të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar.

**KRYETAR KËSHILLI
Hysen KOLDASHI**

